

FATMIR TOÇI

DITARI I PËRBALLJES ME KORONAVIRUSIN

55 DITËT E LUFTËS SIME ME ARMIKUN E PANJOHUR

BOTIMET TOENA

FATMIR TOÇI

DITARI
I PËRBALLJES ME KORONAVIRUSIN
55 DITËT E LUFTËS SIME ME ARMIKUN E PANJOHUR

Me parathënie nga prof. Rexhep Qosja

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Recensent: Akademik Rexhep Qosja

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Behar Gjoka

Korrektore: Majlinda Toçi

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-327-75-8

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: info@toena.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.al

*Me mirënjohje të thellë
për prof. dr. Perlat Kapisyzin dhe stafin e përkushtuar
të Spitalit “Shefqet Ndroqi” në Tiranë,
që më rikthyen në jetë.*

*Familjes sime të bukur,
përkushtimi dhe dashuria e së cilës
ishte terapia më e mirë për të më rikthyer në gjirin e saj.*

DY FJALË SI HYRJE

Libri “*Ditari i përballjes me koronavirusin - 55 ditët e luftës sime me armikun e panjohur*”, që me ndrojtje i paraqitet lexuesit, është një përpyetje për të paraqitur me vërtetësi ngjarjet që lidhen me prekjën time nga virusi Covid-19 në rrethana rastësore, trajtimin në kushtet e vetëkarantinimit dhe, më pas, në regjim spitalor në spitalin “Shefqet Ndroqi”. Gjendja e rëndë dhe shkalla e rrezikut për jetën, kujdesi dhe përkushtimi i personelit mjekësor dhe specialistëve të këtij spitali, përjetimi i çasteve më tipike, të vështira e të rëndësishme psikologjiko-shpirtërore janë ato që e përshkojnë nga dita e parë deri në të fundit këtë libër-ditar.

Qëllimi i këtij libri nuk është për të treguar historinë e një pacientit të infektuar nga koronavirusi, duket nga pakujdesia dhe mosrespektimi sa duhet i masave mbrojtëse, i cili u përball “trimërisht” me vdekjen dhe fitoi “betejën”, por për të treguar një histori të vërtetë vuajtjesh e rreziku e për të

sensibilizuar e mbrojtur të gjithë ata që nuk janë ende të ndërgjegjshëm për rrezikun që paraqet për veten dhe të tjerët ky virus i rrezikshëm dhe ende i panjohur, që nuk zbatojnë masat mbrojtëse të rekomanduara dhe, edhe më keq, zhvillojnë e përhapin opinione e propagandë të dëmshme duke ndikuar në çoroditjen dhe nënvlerësimin e situatës.

Libri është ndërtuar në formën e ditarit për çdo ditë, ku janë bërë përpjekje të mbahen shënime, kur gjendja shëndetësore e ka lejuar këtë gjë. Përjashtim bën ndonjë ditë kur gjendja shëndetësore ka qenë shumë e rëndë dhe ka qenë e pamundur të mbahen shënime; në këtë rast shënimet janë hedhur pas përmirësimit të gjendjes për aq sa ka qenë e mundur të mbahet mend, ose nga rrëfimet e personelit shëndetësor të shërbimit në ato çaste. Bazuar në këto shënime, që janë mbajtur më shumë si pika, apo si çështje të shkurtra, me qëllim për t'i trajtuar më gjerësisht në një kohë të dytë nëse do ta fitoja luftën kundër Covid-19, është shkruar edhe ky ditar sapo kam lënë spitalin dhe jam kthyer pranë familjes, duke u mbetur besnik ngjarjeve, personazheve dhe trajtimit të gjendjes sime shëndetësore.

Ngjarjet dhe personazhet e cituara në libër janë reale dhe autori falënderon dhe kërkon mirëkuptimin e atyre që janë bërë pjesë integrale

e këtij libri me qëllimin e mirë për të ndihmuar në realizimin e idesë së rrëfimit: sensibilizimin e një numri sa më të madh njerëzish për rrezikun e jashtëzakonshëm, që shkakton ky virus për jetën e çdo njeriu dhe për domosdoshmërinë e respektimit të masave të rekomanduara nga institucionet e specializuara shëndetësore për parandalimin e prekjes prej tij.

Falënderime pa fund dhe mirënjohje e thellë, aq sa fjalët janë të varfra t'i shprehin deri në fund, për personelin e spitalit “Shefqet Ndroqi”, mjekët, infermierët, specialistët, sanitaret etj. - në mënyrë të veçantë për prof. dr. Perlat Kapisyzin, drejtuesin e këtij institucioni - që me përkushtimin dhe humanizmin e tyre po shpëtojnë çdo ditë jetë njerëzish nga kthetrat e vdekjes. Jam aq shumë i detyruar ndaj kujdesit dhe përkushtimit të tyre, sa që sot mund ta them pa hezitim e me bindje se nëse nëna ime e mirë më bëri kokën para 62-vjetëve, ata më rikthyen në jetë pas një beteje që dukej e humbur.

I lumtur për familjen time të madhe, dashuria dhe përkushtimi i natyrshëm i së cilës ka qenë pjesë e rëndësishme e terapisë intensive që trupi dhe gjithë qenia ime iu nënshtrua, duke e bërë atë më të bashkuar, më të fortë dhe më të bukur.

Me qindra të afërm, miq, shokë, të njohur e të panjohur që kanë qenë afër meje gjatë kësaj

periudhe me interesimin dhe urimet e tyre për shërim të shpejtë, i falënderoj nga zemra, ma kanë lehtësuar gjendjen time shpirtërore e psikologjike dhe më kanë dhënë kurajë e besim se do t'ia dilja.

Një falënderim i veçantë shkon për prof. Rexhep Qosjen për vlerësimin e pazakontë që ka bërë për këtë libër shkruar enkas si parathënie e këtij “Ditari”, por edhe për interesimin e kujdesin e vazhdueshëm atëror që ka treguar gjatë periudhës që gjendesha në spital në gjendje të rëndë, duke ma shtuar forcën dhe besimin për përballimin dhe mposhtjen e kësaj të keqeje që ka gjunjëzuar dhe futur në panik të gjithë botën.

Do të ndihesha i lumtur nëse ky libër i vogël, i shkruar në kushte të vështira dhe shpesh gati të pamundura, në kufijtë e jetëvdekjes, do të shërbente sadopak për sensibilizimin e njerëzve kudo që janë, për rrezikun e madh që paraqet Covid-19 në vendin tonë dhe në të gjithë globin; për domosdoshmërinë e njohjes dhe të zbatimit të masave parandaluese të përhapjes së tij, në dukje të thjeshta por me rëndësi jetësore, për t'i bërë ato pjesë të kulturës sonë të jetesës në rrethanat e reja të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, edhe për shkak të këtij virusi të pabesë dhe ende të panjohur.

Dua ta mbyll me një mësim të madh nga përvoja e dhimbshme që kalova në muajt më të bukur të

vitit, korrik e gusht 2020, kur destini im ishte që t'i përjetoja si një “turizëm spitalor”: jeta është e bukur dhe e vlefshme kur është e shëndetshme, ndaj të bëjmë çmos për mbrojtjen e saj!

Fatmir TOÇI

Parathënie

RRËFIM PËR TË PAPRITURËN

Nuk jam i vetmi, që s' e ka pritur këtë rrëfim prej Fatmir Toçit. Nuk e kam pritur, sepse është rrëfim për një të papritur me të cilën kur u ballafaqua ai me të, nuk ishin ballafaquar shumë njerëz në Shqipëri e në Kosovë e, madje, as në botë. E papritura e Fatmir Toçit, na e rrëfeu betejën me virusin Korona, të cilin shkencëtarët e pagëzuan Kovid-19.

Është ky një armik i krijesës më të çmuar të planetit të Tokës - armik i njeriut.

Është ky një armik i vogël, që duhet të zmadhohet me mijëra herë me mikroskop për t'u parë prej syve të njeriut. Viruset që shkaktojnë një varg sëmundjesh ngjithëse nuk u nënshtrohen, në asnjë kohë e në asnjë vend, atyre ndryshimeve mes viktimave të tyre. Domethënë virusi Korona, gjatë sulmeve të tij nuk bën dallime mes njerëzve: i sulmon të gjithë pavarësisht kush janë e çka bëjnë në jetë. Ai sulmon pa dallim të vegjël a të mëdhenj! Ai sulmon pa dallim të varfër e të

pasur. Ai sulmon pa dallim të fortë e të dobët. Ai sulmon pa dallim ushtarë e oficerë! Ai sulmon pa dallim shkencëtarë e analfabetë! Ai sulmon pa dallim kryetarë shtetesh dhe qytetarë të sunduar prej tyre. Ai sulmon pa dallim shfrytëzues dhe të shfrytëzuar! Ai sulmon pa dallim ata të cilëve u ngrihen përmendore dhe ata të cilët nuk do të kenë kurrë përmendore!

As kësaj here Korona nuk iu shmang kësaj strategjie: ai sulmoi princin e Britanisë së Madhe dhe varfanjakët e Londrës! Ai sulmoi kryetarin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe afrikano-amerikanët! Ai sulmoi shtetet më të pasura e më demokratike duke iu shkaktuar numrin më të madh në të vdekur e në të infektuar dhe, shtetet më të varfra duke iu shkaktuar kujt më pak e kujt më shumë të vdekur e të infektuar. Virusi Korona e sulmoi edhe Fatmir Toçin tonë, e sulmoi armiqësisht sepse Fatmiri u soll shpërfillshëm ndaj virusit në fillim!

I vetëdijshëm se fati i keq me virusin Korona e shtriu në shtratin midis jetës e vdekjes, ai bëri çmos që gjendjen trupore dhe shpirtërore ta bëjë lëndë të ditarit, të cilin ishte shumë e vështirë ta mbante kur duke hedhur shenjat e fjalëve në fletoren e ndoshta duke i pëshpëritur në teknikën që mbante afër kokës. Dhe, arriti që t'i sillte kontribut praktik mjekësisë gjatë pesëdhjetë e pesë ditëve të luftës me armikun e padukshëm.

Si e arriti këtë kontribut Fatmiri?

E arriti: së pari, duke i përshkruar dhembjet dhe çrregullimet që virusi i shkaktoi trupit dhe shpirtit të tij.

Dhe, së dyti, duke i përshkruar, prej dite në ditë, analizat laboratorike që iu bënë organeve të tij, si mushkërive, zemrës, veshkave, mëlçisë, pankreasit. E të tjera.

Më 17 korrik 2020, ditën e fillimit të mjekimit spitalor, dhjetë ditë pas mjekimit në kushtet e shtëpisë, ai paraqet në ditar këtë gjendje të tij, që e tregojnë analizat e gjakut:

“Pashë edhe rezultatet e analizave të para, mbi 20 lloje ekzaminimesh me gjakun që më kishin marrë me bollëk paradite, nga të cilat më kryesoret ishin: Glicemia 181mg/dl (normalja 60-120 mg/dl), kreatinemi 1.0 mg/dl (<1.3), D-Dimer 724 (0-500 mg/dl), PCR (Proteina C Reaktive) 41 (<10), Ferritinemi 1253 ng/ml (20-400), PO₂ 52.4 mmHg (69-116), Sat. O₂ 85 % (94-95), Kolesterolit 255 mg/dl (140-200) etj. E gjithë periudha e mëpastajme e qëndrimit tim në spital do të ishte një luftë e përditshme dhe e vazhdueshme për arritjen e niveleve optimale të parametrave të këtyre analizave, në mënyrë të veçantë të PCR-së, që tregonte masën e infeksionit të mushkërive, D-Dimer si tregues i nivelit të koagulimit të gjakut për të shmangur rrezikun e trombozave, PO₂ si tregues i oksigjenimit të gjakut etj.”

Duke lexuar përshkrimet e analizave, që i bëhen gjatë pesëdhjetë e pesë ditëve të mjekimit,

lexuesit e *Ditarit* do të shohin, se sa mundimshëm trupi i tij e ka fituar betejën me virusin Korona.

Të gjitha analizat e gjakut, të gjitha kontrollet e organeve, të gjitha mjetet e ilaçet që përdorën mjekët për të shtuar mundësitë jetësore, bëhen pjesë e historisë së sëmundjes së Fatmir Toçit, në të cilën është i përmbajtur përshkrimi i saj pothuaj shkencor. Me këto përshkrime të hollësishme, të përditshme, në *Ditarin* e tij, Fatmir Toçi na këshillon që t'i çmojmë mjekët e t'i zbatojmë këshillat e tyre.

Ditari i Fatmir Toçit është ftesa më e rëndësishme, më konkrete, më thelbësore që u drejtohet në gjuhën shqipe shqiptarëve për të respektuar masat e dhëna prej mjekëve e të miratuara prej qeverive nëse duan të mbrojnë veten e të mbrojnë kolegët e miqtë, të tjerët që takojnë, prej virusit vdekjeprurës Kovid-19. Është e kuptueshme, prandaj, pse në *Ditarin* e Fatmir Toçit janë të shpeshtë emrat e mjekëve, shprehet nderim ndaj mjekëve e infermierëve - këtyre heronjve të kësaj kohe. Në *Ditarin* e tij, në këtë roman dokumentar historik mbi virusin, që atij ia rrezikoi jetën, Fatmir Toçi do t'u shprehë falënderime kolegëve, miqëve të tij, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Greqi, në Luginë të Preshevës, ndër fshatrat e arbëreshëve të Italisë, edhe në diasporën shqiptare në Europë, në Turqi, në

SHBA, të cilët u interesuan për shëndetin e tij, për jetën e tij.

Lexojeni *Ditarin* e Fatmir Toçit. Kjo është vepër e intelektualit me dhunti të dëshmuar krijuese. Kjo është vepër me vlera shkencore dhe artistike. Kjo është vepër që do të ketë ndikim shoqëror dhe etik. Prej luftës që përshkruhet në të për t'i shpëtuar Vdekjes do të çmojmë Jetën. Ajo, Jeta, është shumë e vlefshme, shumë e rëndësishme. Jeta, është shumë e bukur. Dhe, duhet të përpiqemi, ta ruajmë vlerën e saj, rëndësinë dhe bukurinë e saj. Dhe, ta mbrojmë prej të këqijave e rreziqeve që mund t'i vijnë prej anëve të ndryshme ashtu siç e mbrojtën mjekët e infermierët prej virusit Korona, Jetën e Fatmir Toçit.

Akademik Rexhep QOSJA

Prishtinë, 12.11.2020

DITARI I KORONAVIRUSIT

Ka hyrë korriku, moti është i nxehtë dhe plazhet në bregdetin e gjirit të Durrësit kanë filluar të popullohen, veçse ende si me ndrojtje dhe pa asnjë krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Shkaku tashmë dihet, frika nga virusi Covid-19 që ka pushtuar botën mbarë, duke ngadalësuar ritmin në të gjitha aspektet e jetës të shoqërisë dhe duke krijuar probleme serioze jo vetëm në shëndetin e njerëzve, frikën dhe panikun që ka pushtuar secilin prej nesh, por edhe pasojat e rënda në fushat ekonomike e sociale për shumë individë e subjekte në të gjithë vendin. Ky armik i gjithë njerëzimit, i padukshëm dhe ende i panjohur për shkencën e mikrobiologjisë dhe mjekësinë e aplikuar, po ndryshon marrëdhëniet njerëzore dhe mënyrën e sjelljes në familje dhe në shoqëri, në marrëdhëniet ekonomike dhe të punësimit, deri tek ato shpirtërore, kulturore, zakonore etj.

Që pas tërmetit të nëntorit të vitit të kaluar dhe disa dëmtimeve të brendshme në pallatin ku banoj në Tiranë, jemi vendosur në Qerret të

Kavajës, në shtëpinë e plazhit, “vila”, siç e quajmë ne të shtëpisë, e ndërtuar që para 17 vjetësh si rrjedhojë e një projekti për fshatrat turistike. Një ide e guximshme për kohën, që rezultoi e suksesshme, por që u shpërbë pas ndërtimit të tyre për shkak të abuzimeve me ndërtimet dhe interesat e grupeve të ndryshme, duke çuar në shitjen dhe legalizimin e tyre. Pas kontroleve me inxhinierë specialistë dhe riparimeve të dëmeve të tërmetit në apartamentin e Tiranës, familja u kthye në banesën e kryeqytetit, ndërsa unë vijova të qëndroj në Qerret, edhe për t’i dhënë dorën e fundit dy librave studimorë që po shkruaj prej 10 vjetësh për arbëreshët e Italisë e që i kam shumë për zemër. E gjithë kjo periudhë, prej nëntorit 2019 deri në marsin e këtij viti, për mua ka qenë e ndarë midis Qerretit e Tiranës, ku shkoja disa herë në javë për takime, ose punë të tjera në shtëpinë botuese, ndërsa mbledheshim fundjavave të gjithë bashkë me familjen te kjo shtëpi plazhi, ku, pa dyshim, kalohet si s’ka më mirë.

Shpallja e pandemisë nga OBSH-ja (Organizata Botërore e Shëndetësisë) dhe masat drastike izoluese që u morën nga organet shtetërore, për një periudhë ma riktheu përsëri familjen në këtë shtëpi, ku ndiheshim më të mbrojtur dhe mund të lëviznim më lirshëm në zonën bregdetare. Mirëpo Irena dhe vajzat ishin më të lidhura me punët e tyre në Tiranë dhe, duke gjetur hapësirat e mundshme nën urdhrat dhe udhëzimet e organeve

shtetërore, ato u kthyen përsëri në Tiranë, ndërsa izolimi i gjithë vendit e forcoi qëndrimin tim në Qerret, si në periudhën pas tërmetit.

Kështu kaluan maji e qershori dhe hyri korriku, midis ditëve të ngrohta buzë detit dhe tavolinës së punës para kompjuterit, me ankthin e lajmeve të përditësuara për përhapjen dhe pasojat nga virusi i tmerrshëm, por edhe me fundjavat e zhurmshme e të gëzueshme me familjen e madhe, ku më të vegjlit, Edeni, Naisa dhe Noara ishin gjithmonë në qendër të vëmendjes.

E diel, 5 korrik 2020

Besoja se isha gjithmonë i kujdesshëm me masat mbrojtëse të rekomanduara ndaj koronavirusit, mbaja gjithmonë maskë në vende publike, shmangesha nga kontaktet me njerëz të tjerë dhe aq më tepër për masat higjienosanitare personale. Nga media raportohej çdo ditë për numrat e të prekurve me koronavirus, sa pacientë ishin shtruar në spital, numrat e njerëzve që ndërronin jetë dhe ata që dilnin të fituar nga kjo betejë e tmerrshme. Një ritual që, sidoqoftë, aq sa ndikonte në sensibilizimin e opinionit për rrezikun real e të prekshëm, që vinte nga ky armik i padukshëm dhe pothuaj i panjohur, po aq krijonte edhe një atmosferë nervozizmi e paniku që përhapej në mënyrë të mjegulluar te njerëzit.

Në mëngjes u zgjova keq, i pamundur fizikisht. Isha djersitur disa herë gjatë natës, por temperaturën e mata vetëm në mëngjes: 37.5⁰ C. Dyshova, “E hëngra edhe unë!”, ishte mendimi i parë që më përshkoi gjithë qenien, edhe pse nuk po ia pranoja vetes. Shenja tjetër ishte kur zbrita në sallon për të ngrënë mëngjesin, shijen e ushqimit e ndieja, por nuk nuhasja gjë. Asnjë shenjë tjetër. Dita kaloi me një dobësi të lehtë me dëshirë për të mos u marrë me asgjë. Nuk dola në plazh, edhe pse dita ishte ideale për në det, bëra vetëm një shëtitje me Irenën, si zakonisht mëngjeseve në bregdet, duke ecur zbathur nëpër ujin përgjatë vijës bregdetare, nga kanali i Qerretit, i lidhur tashmë me detin dhe i lundrueshëm për varkat dhe skafet e vogla në grykëderdhjen e tij, deri te kompleksi i madh turistik në bregdetin e Malit të Robit. Dreka, e gatuar nga Majlinda, ishte e mirë, me peshk të shijshëm dhe verë të zgjedhur dhe hëngra gjithë oreks, shenja këto që më bënë të bindja veten se isha mirë dhe do të kisha marrë ndonjë ftohje të lehtë. Në atë fundjavë kishin ardhur edhe vajzat e mëdha, Ermela dhe Majlinda, bashkë me fëmijët dhe atmosfera e krijuar bënte që të harroheshin gjithë shqetësimet e tjera.

E hënë, 6 korrik 2020

Vajzat me të vegjlit e tyre u kthyen në Tiranë që mbrëmë, duhet të ishin në punë sot, që herët.

Ndërsa Irena me Merin dhe Laertën u larguan mëngjesin e sotëm. Do të shkoja edhe unë në Tiranë, por e kisha lënë me Skënderin e Peqinit për t'u takuar, ndaj u bëra gati dhe po e prisja të vinte të më merrte. Nata kishte kaluar e qetë, kisha pirë një paracetamol para gjumit dhe kisha fjetur deri në mëngjes. Kjo ma përforcoi mendimin se nuk kisha ndonjë gjë serioze, do të ishte ndonjë ftohje e lehtë, që me sa duket kaloi me kaq.

Skënderi erdhi rreth orës 10:00 dhe paraditja na shkoi në takime, sa në kafenetë e Tiranës në zyrat e shtetit, derisa erdhi koha e drekës. Ai propozoi të kalonim nga Peqini e më pas në Kavajë, të ndalonim në ndonjë nga tavernat tradicionale të qytetit të tij, ku zogjtë e fshatit, kalastrenat, siç i thoshin atje, të pjekur në tava balte me oriz, sallatat e fushës dhe bulmetrat e prodhuara në shtëpi ishin specialitetet e njohura të zonës. Ashtu bëmë, Skënderi telefonoi për të bërë porosinë dhe kur ne arritëm në një tavernë, ndërtuar mbi një kodër të fshatit Gjocaj, çdo gjë ishte gati. Hëngra me shije, por nuk më kaloi pa e vënë re se nuk më ngacmonte si herë të tjera aroma e zogjve të pjekur të sapodalë nga furra dhe e qumështorit të saçit që zverdhëllonte me ca njolla kafe në cipën e mpiksuar të qumështit dhe të vezëve.

Pas disa blerjeve në tezgat e fshatarëve, që shisnin prodhimet e tyre të fushës përgjatë rrugës, u ktheva në shtëpinë e Qerretit. Desha të

punoj, por nuk kisha shumë dëshirë. U shtriva pak në divanin e sallonit, më pas, në muzg dola një shëtitje, si zakonisht deri te kanali i Qerretit, por u ktheva isha më i lodhur se zakonisht. Edhe shkallët për t'u ngjitur në katin e tretë, ku ishte dhoma ime e gjumit, i ngjita me përtesë dhe me gjunjët që më dridheshin. Mendova se një dush do të më bënte mirë, por kur po sillesha nëpër dhomë me mantelin e dushit më mbuluan përsëri djersët. Piva përsëri një paracetamol dhe u përpoqa të fle, por pas mesnate m'u desh të ndërrohesha sepse isha bërë ujë nga djersët.

E martë, 7 korrik 2020

Në mëngjes isha sërish qull nga djersët. Vura termometrën, për dy viza shkonte 38⁰ C. Një dush me ujë jo fort të ngrohtë mendova se do të më bënte mirë. Dhe kështu u duk, veçse gjunjët nuk po më bindeshin lehtë kur bëra të ngjis shkallët për t'u veshur. Djersët më mbuluan përsëri dhe u detyrova të qëndroj për një kohë të gjatë i shtrirë në divanin e sallonit. Dita ishte e bukur dhe me diell, ndaj mendova të dal në tarracë për të marrë ca rreze dielli, por përsëri ndieja vështirësi në ngjitjen e shkallëve, gjunjët nuk më mbanin. Qëndrova pak në sheshpushimin midis shkallëve dhe m'u duk më e lehtë të zbres në një nga dhomat e katit të dytë, u shtriva në shtrat dhe më zuri një gjumë i thellë.

Pothuaj nuk u ula fare për të punuar në kompjuter, nuk kisha dëshirë. Piva sërish një paracetamol dhe iu fala përsëri shtratit me frikën sesi do ta kaloja atë natë.

E mërkurë, 8 korrik 2020

Do të shkonim përsëri në Tiranë me Skënderin. Kisha fjetur jo keq dhe m'u duk vetja se isha më mirë. Takimet për disa punë të Skënderit i mbaruam shpejt, u ktheva pak te zyrat e shtëpisë botuese, pastaj morëm rrugën për në Laprakë, në Spitalin Ushtarak, për të parë Lefter Çipën, i shtruar prej disa ditësh për t'iu nënshtruar një operacioni të vështirë. Më parë, takova në zyrën e tij drejtorin e spitalit, Arben Zenelajn, një i njohur i vjetër me të cilin na lidh edhe origjina e përbashkët nga Kuçi i Kurveleshit. Dhe Sandër Çipën e gjeta aty, bashkë me Anila Bashën dhe më kërkuan që Lefterin ta shihnim në një moment tjetër se ndodhej në reaminacion dhe gjendja nuk ishte aq e mirë. Ishte rasti për të folur edhe për gjendjen time jo fort të stabilizuar, shenjat që më ishin shfaqur, dyshimin se mos isha prekur nga virusi dhe çfarë mund të bëja në një situatë të tillë jo shumë të qartë. “Tamponin, - më tha drejtori, - i ke shenjat. Më mirë ta kapim që në fillim. Nesër në mëngjes eja këtu për të bërë testin e tamponit.” Dhe shtoi me të qeshur: “Me sa duket të gjithë do ta kalojmë në njëfarë mënyre”.

U ktheva në Qerret pasdite vonë. Veç një dobësie të përgjithshme dhe mungesës së dëshirës për t’u marrë me ndonjë gjë konkrete, po ndieja edhe grykët pak të acaruar, një shenjë tjetër kjo, me sa thuhej, kur bëhej fjalë për prekjën nga koronavirusi. Megjithatë nuk ia pranoja vetes dhe gjithmonë besoja se mund të kisha marrë ndonjë të ftohur nga korrentet e ajrit në shtëpi kur mund të kisha qenë i djersitur. Mbrëmja dhe nata kaloi me një shqetësim më shumë, por nuk pata më temperaturë dhe gjatë natës nuk djersita si në netët e mëparshme.

E enjte, 9 korrik 2020

Në orën 09:00 isha në Tiranë, në Spitalin Ushtarak, ku na priste Suela, kryeinfiermjerja e spitalit. Procedura ishte vetëm disa sekonda, marrja e sekrecioneve në grykë dhe në hundë, por pritja e përgjigjes deri të nesërmen në mëngjes do të ishte një makth i vërtetë. Ben Zeneli më telefonoi që pasdite dhe pa i rënë fare rrotull ma dha lajmin: “Testi ka dalë pozitiv!”. Vështirë të përshkruaj me fjalë ndjesinë që më pushtoi gjithë qenien: m’u duk vetja i mbetur në një udhëkryq të shkretë, ku nuk dukej të kalonte dikush për të më treguar rrugën që duhet të merrja... Dëgjoja çdo ditë për njerëz, të njohur e të panjohur, të

prekur nga virusi, por kurrë nuk e kisha afruar te vetja. Solla nëpër mend ku kisha qenë dhe kë e në çfarë rrethanash kisha takuar ditët e fundit, por asnjë nuk më dukej rasti i mundshëm i infektimit. Mbaja gjithmonë maskë kur dilja jashtë shtëpisë, ose kisha takime me njerëz të ndryshëm, edhe kur të tjerët përballë meje nuk e mbanin, por, ja, nuk paska qenë e thënë.

Do të kalonte një mbrëmje dhe një natë e trazuar me mijëra skenarë në kokë se çfarë mund të bëja, si mund ta kaloja sa më lehtë pa shqetësuar dhe frikësuar të tjerët, duke filluar nga familja ime, në përbërje të së cilës ishin të gjitha moshat, duke filluar nga të vegjlit e deri te prindërit e Irenës që, sipas atyre që thuheshin rëndom, ishin mosha më e rrezikuar lehtësisht për t'u prekur nga virusi. Ishte e qartë se unë isha një rrezik potencial për pjesëtarët e tjerë të familjes dhe as që bëhej fjalë që mund të rrija bashkë me ta për një periudhë, derisa të kalonte...

Nata kaloi më shumë zgjuar, duke u rrotulluar në shtrat. Vetëm nga mëngjesi, i lodhur dhe i dërrmuar nga mijëra mendime që më kishin pushtuar të gjithë qenien, më zuri një gjumë i thellë dhe i hapa sytë vetëm nga mesdita.

E premte, 10 korrik 2020

Zyrtarisht pozitiv, ishte mendimi i parë sapo hapa sytë. Çova gjithë familjen për të bërë testin e tamponit, por të gjithë dolën negativë, përveç Laertës që rezultoi pozitive si unë. Edhe pse negativë, edhe pjesa tjetër e familjes u ngujua në Tiranë për të respektuar vetëkarantinimin meqë dy pjesëtarë të familjes, kishin dalë pozitivë. Irena nuk do të dilte në zyrat e shtëpisë botuese për dy javë, po ashtu edhe Ermela, Majlinda dhe Meri nuk do të shkonin në punë, në zbatim të udhëzimeve të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë. Ndërkohë Enea, më i vogli i shtëpisë, vijonte të qëndronte me pushime në Sarandë te miqtë e tij dhe nuk kishte gjasa të kthehej para fundit të gushtit.

I telefonova dr. Pëllumb Piperos dhe i shpjegova gjatë e gjerë ç’kishte ndodhur dhe si ishte situata.

“Duhet të vish nesër për skaner”, më tha dhe e lamë që rreth mesditës të isha në spital për të bërë skanerin e mushkërive. Ndërkohë e menduam familjarisht një organizim të vogël në kushtet e reja të prekjes nga koronavirusi: unë dhe Laerta do të vetëkarantinoheshim në shtëpinë e plazhit në Qerret, derisa të kalonte kjo situatë, pjesa tjetër e familjes do të qëndronte në Tiranë, ku nuk do të hynte njeri tjetër në banesë. Gjatë kësaj periudhe, Irena dhe vajzat mund t’i mbanin marrëdhëniet me punët e tyre nëpërmjet komunikimit *on line* sa herë do të ishte e nevojshme.

U vendosëm në katin e dytë të vilës me dhomat ngjitur, të dyja me pamje nga deti. Laerta e kalonte pjesën më të madhe të ditës në sallonin e katit të parë dhe në kuzhinë duke gatuar, unë më tepër në dhomë duke lexuar, ose duke kontrolluar pareshtur kanalet e televizorit. Zbrisja poshtë vetëm për të ngrënë, ose për të bërë ndonjë shëtitje të shkurtër para shtëpisë, ose në bregdet, herët në mëngjes ose në orët e vona të mbrëmjes.

E shtunë, 11 korrik 2020

U ngritëm që në mëngjes herët, dola pak deri te bregu i detit, u ktheva e bëra një dush dhe, pasi hëngra mëngjes, u bëmë gati për rrugë. Në orën 11:00 u nisëm nga Qerreti, ndërsa në mesditë kishim mbërritur në Sanatorium, ku dr. Pëllumb Hysko na priste për skanerin. Një punonjëse me emrin Gerta na priti gjithë përkujdesje, ndërsa mjediset dhe aparaturat të gjitha, me sa duket, të reja dhe të mirëmbajtura të krijonin një ndjesi qetësie e besimi. Procedura e kryerjes së skanerit ishte e shkurtër, pas meje u fut Laerta për kontrollin në skaner dhe pas më pak se gjysmë ore unë e kisha në telefonin tim në *WhatsApp* videon e skanerëve. Pa arritur t'i telefonoj unë, më mori dr. Pipero, që me sa duket ishte informuar për rezultatet e skanerëve. Laerta ishte krejt e pastër,

ndërsa mushkëritë e mia rezultonin të prekura nga virusi i tmerrshëm.

- E pashë skanerin, - më thotë Pëllumb Pipero, - mos u shqetëso se do të kalojë. Qetësohu tani dhe do të lidhemi më vonë për medikamentet që duhet të marrësh.

I kërkova të di me siguri nëse mund ta kaloja në kushtet e shtëpisë, i vetëkarantinuar dhe me kurën e ilaçeve që ai do të rekomandonte.

- Mirë do të ishin disa ditë në regjim spitalor nën kujdesin e afërt të mjekëve, - më tha në mëdyshje. - Por, me sa shoh është në fazë fillestare, - më siguroi duke parë heshtjen time nga ana tjetër e telefonit - do ta kalojmë bashkë, pa merak.

Në fakt ishte përgjigjja që doja, pasi shtrimin në spital as që e mendoja dhe nuk hynte fare në opsionet e mia. Dr. Pipero më dërgoi listën e ilaçeve: *Dexamethasone*, *Levofloxacin*, *Clarithromycin*, *Fraxiparine*, si dhe *Tachipirina* për uljen e temperaturës. Ia kalova listën e ilaçeve Irenës për t'i marrë në farmaci, ndërkohë që me Laertën u kthyem në shtëpinë e Qerretit.

Ky ishte gabimi im i parë fatal që bëra në këtë ditë, nga nxitimi, nga lajmi se mushkëritë e mia ishin prekur, por edhe nga paniku përballë të panjohurës që më priste. E mora shumë lehtë idenë dhe as që e konsiderova mundësinë për t'u shtruar disa ditë në spital për të qenë nën kujdesin e mjekëve që në këtë fazë fillestare të prekjes

nga virusi. Ndoshta pak ditë në spital në atë fazë fillestare të sëmundjes do të bënte që bashkëjetesa ime me virusin të ishte më e shkurtër, më e lehtë dhe mund të ndërronte rrjedhjen e ngjarjeve.

E diel, 12 korrik 2020

Fundjava është e mbipopulluar dhe më e zhurmshme këtu, në bregdetin e Qerretit. Nga dritaret dhe veranda e shtëpisë duket gjithë hapësira e plazhit me atmosferën e saj që krijohet nga pushuesit e shumtë. Nuk dal në det dhe as në rërën e plazhit që ndan detin nga shtëpia ku banoj: respektoj karantinën për veten dhe të tjerët. Sillem rrotull nëpër oborr, ngjitem në tarracën e madhe të vilës dhe vetëm në mbrëmje vonë, bëj, i vetmuar, një shëtitje buzë detit.

Edhe ngjitjet në tarracë kanë filluar të më bëhen të mundimshme, më priten gjunjët, mbushem me djersë dhe ndaloj në çdo sheshpushim të shkallëve për t'u mbushur me frymë e për të marrë pak veten. Dushin e bëj shpesh, edhe gjatë ditës kur djersij e ndërroj rrobat, duket që më lehtëson për momentin, por pasi dal ndiej një këputje e dobësi në gjithë trupin sa i drejtohem shtratit për t'u qetësuar. Kam filluar të rri më shumë shtrirë gjatë ditës dhe mendoj se është efekti i antibiotikëve dhe i kortizonëve që kam filluar të marr. Rri gjysmë i shtrirë, mbështetur te koka e shtratit

duke soditur përtej vetratës sa e gjithë faqja e murit, ku shfaqet e gjithë pamja e plazhit, deti me anijet që presin radhën për të hyrë në port, si dhe vinçat e lartë të portit, e deri te ndërtesat e bardha të Durrësit, mbuluar shpesh nga një tis mjegulle që e bën edhe më ekzotike pamjen. Midis plazhit dhe shtëpisë ngrihet një brez i ngushtë pishash të larta, një pjesë e të cilave edhe brenda oborrit të shtëpisë, të gjelbëruara në pjesën e sipërme, aq sa të mos e pengojnë pamjen e plazhit dhe detit.

“Çfarë padrejtësie! - mendoj për një çast. - Të gjithë të zhveshur në det, apo çadrat e vendosura në rërën e plazhit para shtëpisë sime, vetëm 100 metra nga vija e ujit, ndërsa unë duhet të rri shtrirë, mbërthyer në krevat, i pamundur edhe për të zbritur e ngjitur normalisht shkallët e katit të dytë të banesës.”

E hënë, 13 korrik 2020

Sidoqoftë, janë ende ditë në dukje normale, pa shqetësime të mëdha, siç dëgjojmë përditë për ata që i ka mbërthyer virusi, që e kalojnë në kushte shtëpie apo në spital: lëviz nëpër shtëpi dhe në oborr, ha normalisht, i shijoj gjellët, edhe pse nuhatja më ka lënë, punoj në kompjuter për librin, shoh gjatë në televizor. Me të tjerat në shtëpi merret Laerta, ku, për momentin, banonim vetëm ne të dy. Po provoja atë që do të përjetoja

në ditët e ardhshme: askush nuk beson sa e rëndë dhe e rrezikshme është kur prekesh nga virusi, nëse nuk e provon vetë në kurriz. Por kostoja e kësaj prove do të ishte gati fatale dhe shumë të prekur, çdo ditë e më shumë, nuk do të kishin rast t'ua tregonin të tjerëve me gojën e tyre...

Dr. Pipero më kishte dërguar listën e ilaçeve që duhet të përdorja dhe Irena i kishte blerë në farmaci, por një pjesë e tyre ishin injeksione që duheshin bërë dy herë në ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje. Vila ku banoj është në bregdet, në një largësi rreth 3-4 km nga Kavaja, dhe unë nuk mund ta bëja këtë itinerar dy herë në ditë. E vetmja zgjidhje ishte të gjendej një infermier nga Kavaja, ose Golemi, që të vinte dy herë në ditë në shtëpi. U lidha me Kujtimin, vëllain e madh që banon në Kavajë, por ndërkohë u kujtova për Vasipin, shok i imi që në shkollë të mesme. Vasipi më sugjeroi një infermier nga Kavaja, i cili ishte i gatshëm që ta kryente këtë shërbim dy herë në ditë. Quhet Safet dhe është shumë korrekt me oraret.

E martë, 14 korrik 2020

E marta nuk u duk e mirë që në mëngjes. Gjumi më doli herët, por po përtoja të ngrihesha. Infermier Safeti erdhi, si zakonisht në orën 08:00, më shpoi në bark dhe në të ndenjura dhe

iku menjëherë se kishte edhe disa angazhime të tjera. U rrotullova gjatë në krevatin e gjerë, por nuk po gjeja karar. Laerta më thirri dy-tri herë që të zbrisja për mëngjesin, por kur pa se nuk po lëvizja nga vendi, erdhi lart me një tabaka të madhe në dorë, ku kishte vendosur ato që kishte përgatitur. Paraditja kaloi në shtrat, duke parë në televizor apo duke soditur përtej vetratës pamjen e gëzueshme të plazhistëve. Për drekë zbrita në katin e parë, ku ishin kuzhina dhe salloni, por me vështirësi dhe shumë ndalesa i ngjita përsëri shkallët për t'u ngjitur në katin e dytë, ku ishte dhoma e gjumit. Loni, shoferi i "Toena"-s, solli aparatën e oksigjenit dhe e vendosëm në dhomën e gjumit pranë krevatit. Ndihesha më i lehtësuar kur vendosja maskën e oksigjenit, edhe pse aparati bënte një zhurmë që të bezdiste.

Në mbrëmje temperatura për herë të parë i kaloi shifrat 38.5 gradë. Digjesha i tëri. Dr. Piperi udhëzoi përdorimin e *Tachipirina*-s në çdo 6 orë. Në të vërtetë *Tachipirina*, edhe në raste të tjera kur e kisha përdorur, ma ulte menjëherë temperaturën, por më mbyste me djersë.

Për darkë përsëri nuk zbrita në sallonin e katit të parë, i thashë Laertës se po përtoja, por ajo e shihte se gjendja ishte rënduar. Zbriti poshtë dhe dha alarmin në Tiranë se gjendja ime nuk ishte e mirë dhe vërshuan të gjithë para mesnate: Irena, Majlinda, Ermela me Gridin, Meri me Sindin. Gjatë rrugës Irena ishte lidhur me dr. Piperon, u

lidh përsëri në telefon kur mbërriti në dhomën time që ta dëgjoja unë dhe rekomandimi i tij ishte që t'i drejtoheshin spitalit, por refuzova kategorikisht. Nuk e afroja kurrë idenë se mund të shtrohesha në spital. Ky do të ishte gabimi im i dytë fatal: nëse do të shkoja që atë natë në spital me siguri që gjërat do të shkonin ndryshe.

Duket që *Tachipirina* e bëri punën e vet, temperatura ra dhe u qetësua disi. Kur pas pak, në të gdhirë, më këputi gjumi, të tjerët u nisën për në Tiranë; qëndruan Meri me Sindin, që Laerta të mos mbetej vetëm nëse gjendja ime rëndohej.

E mërkurë, 15 korrik 2020

Për çudinë time e mërkura nisi disi më e qetë. Temperatura ishte nën kontrollin e *Tachipirina-s*, nuk kam probleme me oreksin, pi shumë lëngje dhe ujë. Mendova se kaloi gjendja kritike dhe se antibiotikët e kortizonët po e bënë punën e tyre. Por nga shtrati lëvizja pak, sa për të kryer nevojat personale e higjienike, për të bërë një dush për të shpëtuar nga kripërat e djersës dhe për t'i dhënë një freski e gjallëri trupit. Pjesa tjetër e ditës kalon me sytë tek ekrani i televizorit që kam përballë, përtej fundit të shtratit dhe, përtej tij, nëpërmjet faqes së qelqtë të murit të shtëpisë, pamja e mrekullueshme e plazhit me pisha, e detit dhe e Durrësit të zhytur në një sfond mjegulle që e bën

qytetin e lashtë edhe më mistik e tërheqës. Dhe përsëri mendova: “Ç’padrejtësi!”, si në vargjet e Nolit: “Pranë *detit* i palarë...”, i pafuqishëm për të lëvizur e për të rendur gjithë jetë si të tjerët nga çadrat mbi rërë në det, duke luajtur futboll, apo volej në rërë, apo në kafenenë “Aromë deti” të Krenarit këtu pranë, që gëlonte nga pushuesit.

Sidoqoftë, më qetëson kjo pamje që e shoh prej gati 20 vjetësh, kur mundëm të ndërtojmë këtë shtëpi të bekuar, e cila ndërroi, në njëfarë mënyre, rrjedhën e jetës sonë familjare.

Vajzat shkojnë e vijnë nga Tirana në Qerret e anasjelltas me një fluks marramendës, me një grafik të pashkruar, që vetëm ato e dinë. Sa të mira që janë! Duhet të jem nga baballarët më të lumtur në botë. Familja është bërë NJË, më shumë se kurrë! Kujdesi i saj rrjedh natyrshëm dhe kjo ma bën të lumtur çdo çast.

Edhe sot qëndruan të gjithë në Qerret deri afër mesnatës, pastaj u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre. Mbeta vetëm me Laertën, rojë vigjilente në dhomën ngjitur me mua, e cila pothuaj nuk fle fare, derisa e këput gjumi kur fillon të agojë.

E enjte, 16 korrik 2020

Kam djersitur gjithë natën. Ndoshta do të kem pasur pak temperaturë, por nuk e kisha

vënë termometrën. Megjithatë, paraditet kalojnë më lehtë, pas netëve që janë më të trazuara dhe trupi nuk gjen lehtë qetësi. U ngrita dhe vajta me vështirësi në tualet, këmbët më dridheshin e nuk më bindeshin si zakonisht dhe është dita e parë që nuk munda të bëj dush. Laerta më sheh me frikë e me trishtim, nuk flet, por kushedi se çfarë i thotë s'ëmës, Irenës, dhe motrave, me të cilat është në komunikim të vazhdueshëm. Prej dy ditësh nga grykët e acaruar nxjerr herë pas herë sekrecione të zeza, por mendoj se ngjyra e tyre e zezë vjen nga çajrat e shumta natyrale që Ermela m'i ka marrë tek Ylli Merja, i njohur si prodhues popullor i bimëve mjekësore. Kur i kisha thënë dr. Piperos për sekrecionet e zeza që nxirrja nga goja, kërkoi të vija menjëherë në spital, madje të më dërgonte ambulancën, por u qetësua kur i tregova për çajrat që pija.

Erdhën përsëri të gjithë pasdite dhe këmbëngulja e tyre ishte t'i drejtoheshim spitalit. Nuk po vendosja ende dhe ky do të ishte gabimi im i tretë fatal e me pasoja të rënda, edhe pse të gjithë po më luteshin gati me lot ndër sy.

E lamë si opsion për të nesërmen një vizitë në spital. Ndërkohë Irena, pa e ditur unë, e trembur nga gjendja, kishte njoftuar në numrin e urgjencës 127 për të dërguar një ambulancë. E dëgjova rastësisht lajmin për ardhjen e ambulancës dhe ulërita që ta anulonin. Nuk dua kurrsesi që

ambulanca të vijë në shtëpinë e plazhit. Jemi në kulmin e sezonit turistik dhe plazhi është i mbushur plot me pushues që duan ta kalojnë sa më mirë e më qetë atë kohë që kishin planifikuar larg terrorit të afrimit të virusit. Pastaj, blloku i shtëpive-vila, apo i apartamenteve është si një lagje e mbledhur ku të gjithë njihemi dhe shkojmë mirë me njëri-tjetrin dhe nuk dua t'ua shtoj këtë shqetësim e merak në kohë të sezonit të pushimeve.

Ambulancën arritëm ta ndalojmë në kohë, por pasditja dhe mbrëmja nuk po premtinin përmirësim të gjendjes. Ishin mbledhur përsëri të gjithë aty: Irena, Majlinda, Ermela me Gridin, Meri me Sindin, si dhe Laerta. Të gjithë ngulnin këmbë të niseshim sa më parë në spital, të paktën për të bërë një kontroll dhe një skaner tjetër. Kurimi në shtëpi dukej se nuk po jepte rezultat. Por unë nuk isha ende shpirtërisht gati dhe plus që disa gjëra duheshin përgatitur në rast të shtrimit në spital. Duke e parë gjendjen time, që po shuhesha ngadalë, e kisha ndier se sapa të arrija në spital do të më shtronin menjëherë. Ky ishte gabimi im i katërt fatal nga ditët e karantinës në shtëpi. U premtova vajzave se do të niseshim të nesërmen në mëngjes. Më parë duhej gjetur një pajisje me bombol oksigjeni portative që ta kishim në makinë gjatë rrugës nga Qerreti i Kavajës për në Tiranë dhe këtë e mori përsipër Gridi, nëpërmjet një të afërmit të tij që punonte si shofer ambulance në

Tiranë. Me përgatitjen e një çante me rroba për t'i pasur me vete u mor Meri.

Do të kalonte edhe një tjetër natë e vështirë për mua në shtëpinë e plazhit. Laerta druhej të rrinte vetëm me mua, ndaj qëndruan edhe Meri me Sindin, që nuk vunë gjumë në sy gjithë natën dhe më ruanin me radhë. Në mëngjes do të ishin të gjithë aty...

E premte, 17 korrik 2020

Kaloi një natë e trazuar, herë zgjuar e herë në një gjumë të rëndë si në kllapi. Si nëpër mjegull mbaj mend disa ndërrime bluzash nga djersa. Por temperaturë nuk kisha pasur, duket që efekti i *Tachipirina*-s kishte bërë punën e vet. Ishin mbledhur të gjithë aty, katër makina në oborr prisnin të niseshim drejt Tiranës. Gridi po merrej me montimin e bombolës së oksigjenit në makinën e Irenës, që shpesh e përdornin edhe Meri me Laertën. Me vështirësi kreu punët e mëngjesit, u rrova dhe bëra një dush; dhe bëra mirë edhe pse nuk e dija se nga kjo ndjesi dhe nevojë jetike mund të privohesha me javë të tëra në spital.

Mëngjesin e mora normalisht, nuk kisha probleme me oreksin, madje ushqimet i shijoja, pavarësisht se nuhatja më kishte lënë prej ditësh. Mbyllëm shtëpinë dhe të gjitha makinat morën

rrugën për në Tiranë, drejt Sanatoriumit. U sistemova në sediljen e prapme të makinës, pranë kisha bombolën e oksigjenit, e cila nëpërmjet një tubi plastik ishte e lidhur me maskën që e mbaja në fytyrë. Laerta po e çonte babanë e saj në spital, me një shqetësim që i lexohej lehtësisht në sy dhe në gjithë fytyrën.

Në spitalin e Sanatoriumit arritëm rreth mesditës, drejt e në repartin e radiologjisë, ku na priste dr. Pëllumb Hysko, kujdesi dhe korrektesa e të cilit më kishin lënë mbresa që kur bëra skaner për herë të parë rreth një javë më parë.

Procesi i skanerit nuk zgjati shumë, punë minutash, por çehra në fytyrën e dr. Pëllumbit nuk më pëlqeu fare. I kërkova të më thoshte diçka paraprakisht, por ai iu shmang kërkesës sime. “Do ta nis me *WhatsApp*, - më tha. - Kam nevojë ta shoh më mirë.” Dhe ishte siç e mendova, sepse më përcollën drejt e te reparti i urgjencës së Sanatoriumit.

I dërgova një mesazh nga telefoni drejtorit të spitalit, prof. dr. Perlat Kapisyzit për ta njoftuar se isha tek urgjenca. “Më prit, vij për tri minuta”, ishte përgjigjja e tij po me mesazh telefonik. Ndërkohë, në repartin e urgjencës po mbaronin procedurat e shtrimit me porosi të tij: më vunë tubat dhe maskën e oksigjenit në hundë e në gojë, më bënë një sërë analizash e kontrollesh të tjera dhe sollën një karrocë pacienti me të cilën do të më shoqëronin deri në pavijon.

Prof. Perlati erdhi vërtet shpejt, pa mbaruar ende procedurat dhe kontrollin në repartin e urgjencës.

- Po ku je, mo?! - më thotë për të më ngacmuar.
- Ke qenë edhe para një jave këtu në spital dhe nuk erdhe të më takosh!

Kishte të drejtë, aq i hutuar isha atë ditë sa nuk e kisha menduar e vlerësuar si duhet. Ndoshta edhe ngaqë isha i bindur që të kthehesha te shtëpia e Qerretit dhe ta vijoja kurimin aty, pa qenë nevoja t'i drejtohesha spitalit. Njiheshim prej 20 vjetësh me doktorin. Rasti ishte botimi i një libri të tij profesional në shtëpinë tonë botuese. Shpresoj të ketë qenë ogur i mirë në karrierën e tij akademike dhe si mjek.

- Nuk kam dashur t'ju shqetësoj, - i thashë.
- Të kam ndjekur në këtë periudhë, i di si i ke ngarkesat.

- Po, po, - më thotë me një buzëqeshje të sforcurar.

- Si doli skaneri i sotëm? - e pyes duke e parë në sy. - Doktor Pëllumbi nuk reagon, duket se nuk ka dalë mirë...

Më sheh në sy, heziton një çast dhe flet me gjysmë zëri:

- Jo mirë!

- Jo mirë, apo keq? - e pyes pa ia ndarë sytë. E vërteta e përgjigjes nuk pritej shumë nga fjalët sesa nga shprehja e çdo muskuli të fytyrës. Dhe

vazhdova më tej: - Bashkë flasim hapur, ndryshe çfarë kuptimi do të kishte?!

- Më keq se para një jave, - më thotë. - Po këtu do të jemi, do të flasim...

Më vunë në një karrocë, bashkë me bombolën e oksigjenit. Irena mundi të hyjë brenda mjediseve të urgjencës për të më parë edhe një herë dhe për të marrë rrobat që hoqa. Karroca përshkoi disa korridore, u ngjitëm me ashensor në katin e dytë të godinës, në pavijonin e kirurgjisë abdominale, i përshtatur për trajtimin e pacientëve të prekur nga Covid-19, në një dhomë që e kishin bërë gati. Nuk ishte keq dhoma që më kishin caktuar, e vogël, por me tualet më vete, madje kishte edhe dush me ujë të ngrohtë. Dritarja ishte nga lindja, pranë kokës së krevatit nga ku mund të shihej mali i Dajtit me gjithë madhësinë e tij. Krevati ishte me komandim me pult për ta përshtatur në pozicionin e dëshiruar, ndërsa përreth tij ishin instaluar të gjitha aparaturat dhe aksesoret e nevojshëm për trajtimin e pacientit. Në faqen e murit, ku ishte ngjitur krevati, ishin fiksuar pajisjet e oksigjenit, dy burime oksigjeni të vazhdueshëm, që ishin të lidhura me sistemin qendror të furnizimit me oksigjen. M'i vendosën të gjithë aksesoret, oksigjenin dhe aparaturat e tjera, më rrethuan me tuba plastikë e kablllo në gjithë trupin dhe rashë në gjumë si i vdekur.

Por, pas pak, erdhi infermierja për të marrë gjak për analizat e para dhe për të pyetur nëse ishte

çdo gjë në rregull dhe a kisha nevojë për ndonjë gjë. Do të niste nga dhoma, që mbante numrin 35, një kalvar i gjatë analizash, injeksionesh, terapie e plot gjëra të tjera, që kurrë nuk i kisha provuar dhe as që kam për t'i marrë vesh ndonjëherë sesi funksionojnë.

Reparti i kirurgjisë abdominale, ku më sistemuan në fillim, sapo është përshtatur për pavijon anti-Covid, me pajisje, personel, drejtues e shërbime të tjera dhe duket se funksionon mirë. Infermierët nuk ndalojnë asnjë çast, sanitaret me mjetet e pastrimit hyjnë e dalin në çdo dhomë edhe kur nuk i thërret njeri. Ushqimi për pacientët është i zgjidhur me katering, i pastër dhe i pranueshëm si gatim.

Mbrëmja e parë ishte e zyrtë, më kap herëherë një makth dhe s'di t'i përgjigjem pyetjeve që më ziejnë në kokë: pse jam këtu, si do të më shkojë filli, a do të mund të dal që këtej për në jetën normale... e plot të tjera si këto.

Me personelin krijohet një lidhje e çuditshme që pas takimeve të para, të duket sikur i ke njohur prej kohësh dhe zhduket çdo distancë në marrëdhëniet me ta, meshkuj apo femra qofshin. Të gjithë janë të sjellshëm e të gatshëm të përgjigjen për çdo gjë, edhe për gjërat më të vogla, të njohura e të parëndësishme për ta, por të rëndësishme e me ndikim në gjendjen e pacientit. Të gjithë janë të pajisur me veshje mbrojtëse të veçantë nga koka deri te këmbët, madje edhe me një plastikë

mbrojtëse në fytyrë që të kujton policët. Duken si UFO, të gjithë njësoj dhe lehtësisht i ngatërron, sidomos infermieret. Megjithatë, disa prej tyre fillon t'i identifikosh për zellin me të cilën e bëjnë punën e tyre. Kështu, për shembull, Vasili, të cilin të gjithë e thërrasin Taso, djalë mësuesi, i kudondodhur dhe punëmbarruar. Për çdo gjë që nuk zgjidhet apo ka vështirësi i drejtohen Tasos, i cili nuk thotë kurrë jo. U bëmë miq që në minutat e para; kishte mësuar italishten me librin tim “Gjuha italiane pa mësues” dhe këtë ua thoshte të gjithëve. Çdo 10-15 minuta kalonte nga dhoma ime, hapte përgjysmë derën dhe hidhte një sy nëse isha mirë dhe nëse kisha nevojë për gjësend. Kjo më bënte të ndihesha mirë e i sigurtë, sidomos natën kur kishte më pak lëvizje dhe personeli kalonte më rrallë nëpër dhoma, veç rasteve kur pacienti shtypte butonin e ziles të instaluar te koka e krevatit. Po ashtu edhe Geri, një djalë i ri dhe i gjatë, simpatik dhe i kërkuar nga të gjithë. Ishte edhe një infermiere çame vlonjate, Ela Ahmeti; vlonjatët lidhen me njëri-tjetrin edhe pa arsye, e jo më në raste si ky që më kishte zënë mua. Mjekja Valentina Hima është caktuar të ndjekë ecurinë e trajtimit tim. E butë, e kujdesshme, e dashur, më ka qetësuar shpesh me bisedat e saj për gjendjen time shëndetësore dhe ecurinë e sëmundjes. Si përmbledhje fillestare, për sa pashë në ditën e parë, mund të them se ky ishte një

organizim i përbindshëm i krijuar për të shpëtuar jetë njerëzish.

Munda t'i shoh pak nga dritarja e dhomës Irenën dhe vajzat që nuk shkuleshin nga oborri i spitalit pa më parë sadopak. As që më shkonte ndër mend se vetëm pak ditë më pas nuk do të mundja të lëvizja nga krevati e jo më të dilja te dritarja.

Pasdite erdhi në dhomën time doktoreshë Vali. Ardha e saj i paraprinte vizitës së prof. Perlatit dhe grupit të mjekëve që e shoqëronin në pasditen e vonë. Me një tufë blloqesh e fletësh me shënime në dorë, ajo ndenji gjatë dhe foli për gjendjen time. Rezultatet e analizave të para, që kisha bërë sapo hyra në spital dhe kur u sistemova në dhomë, kishin dalë dhe ajo më tregoi një evidencë-pasqyrë ku do të pasqyroheshin çdo ditë rezultatet e analizave të mia, për të ndjekur çdo ditë ecurinë e sëmundjes sime. Në kartelën e ecurisë time spitalore, veç të tjerash do të shkruhej: “Shtrohet në SUSN, më dt. 17.07.2020 me diagnozën Pneumonia interstiale bilaterale SARS-COV-2 dhe sëmundje shoqëruese Tiroidit Hashimoto. Pacienti plotësohet me ekzaminime, CT thoraxi (17.07.2020) që rezulton me progresim imazherik për Covid-19 në krahasim me CT ambulatorë të mëparshme”.

Disa nga rezultatet e analizave të para, nga mbi 20 lloje ekzaminimesh me gjakun që më kishin marrë me bollëk paradite, ishin: Glicemia 181mg/

dl (normalja 60-120 mg/dl), Kreatinemi 1.0 mg/dl (<1.3), D-Dimer 724 (0-500 mg/dl), PCR (Proteina C Reaktive) 41 (<10), Ferritinemi 1253 ng/ml (20-400), PO₂ 52.4 mm Hg (69-116), Sat O₂ 85% (94-95), Kolestrol 255 mg/dl (140-200) etj.

E gjithë periudha e mëpastajme e qëndrimit tim në spital do të ishte një luftë e përditshme dhe e vazhdueshme për arritjen e niveleve optimale të parametrave të këtyre analizave, në mënyrë të veçantë të PCR-së, që tregonte masën e infeksionit të mushkërive, D-Dimer si tregues i koagulimit të gjakut për të shmangur rrezikun e trombozave, PO₂ si tregues i oksigjenimit të gjakut etj.

Prof. Perlati erdhi në pavijon para mbrëmjes. Ishte një ritual që bëhej dy herë në ditë, i shoqëruar nga një ekip mjekësh e specialistësh dhe ndalonte dhomë më dhomë te çdo i sëmurë duke u marrë gjatë me secilin prej tyre dhe duke lënë porositë për vazhdimësinë e trajtimit. Ishte një praktikë me shumë efekt kjo, jo vetëm nga ana psikologjike, domosdo, por edhe nga ana praktike, pasi vendimi për ecurinë e trajtimit për çdo pacient merrej nga konsulta e shumë mjekëve. M'u duk si shpura e një gjenerali që viziton ushtarët e tij të plagosur pas një beteje në spitalin e luftës.

Kur erdhi në dhomën time u mor gjatë më kartelën dhe analizat e shumta. Rrotulloi nëpër duar fletën e skanerit dhe të grafisë dhe nuk po fliste. U përpoqa që ta çliroj unë i pari bisedën:

- Duket keq, apo jo?

- Po, - tha. - Më keq nga ç'e prisja. Je vonuar shumë për të ardhur. Skaneri i dytë tregon rritje të infeksionit në përmasa të mëdha...

- Më shumë se gjysma? - e pyes duke kërkuar ta shoh në sy.

- Po, më shumë.

- Më shumë se 60%? - ngulmova.

- Po, më shumë.

Nuk ngulmova më tej, mendova se do të ishte rreth 70% e mushkërive të prekura nga infeksioni për shkak të Covid-it.

- Do t'ia dalim? Ka shpresë? - pyeta pothuaj instinktivisht. Në ato çaste do të pranoja edhe ndonjë gënjeshtër, veçse të kishte një përgjigje shpresëdhënëse. Por ai e gjeti një rrugë të mesme:

- Ndaj jemi këtu, - tha zyrtë, pa më parë në sy. - Po për këtë, së pari duhet të kemi besimin te vetja. Është e rëndësishme kjo. Dakord?

- Dakord, - thashë instinktivisht, pa e kuptuar deri në fund këtë kërkesë. Tekefundit unë isha aty me besimin dhe shpresën e vetme te prof. Perlati. - Por jo vetëm me pantomima, d.m.th. pa folur, - dhe qesha pothuaj me zor.

U nis drejt derës ngadalë, sikur të kishte ende për të thënë diçka, por nuk foli.

- Kam edhe diçka, - i thashë në mëdyshje, - që ndoshta s'ka lidhje me ju.

Ngriti sytë në formë pikëpyetje si për të thënë "Po? Çfarë është?"

E mblodha pak veten dhe fola ngadalë:

- Kam shkruar një libër për arbëreshët, që e quaj punën e jetës sime dhe e kam dorëzuar për botim.

Ai po më shihte me një shprehje çudie në fytyrë sikur të më thoshte: “Ç’lidhje ka kjo me mua, apo me këtë që po bisedojmë rreth gjendjes së shëndetit tënd?!”. E mblodha pak veten dhe vijova:

- Kam 20 vjet që mbledh materiale, 11 vjet që kam vizituar çdo fshat e vendbanim arbëresh në Itali deri në detajet më të vogla dhe gati 5 vjet që e shkruaj.

Ai vijonte të më shihte me vështrim pyetës se çfarë kërkoja prej tij.

- Dua ta shoh të botuar këtë libër, profesor, - i thashë. - Ne jemi njohur 20 vjet më parë në botimin e librit tuaj te ne, dhe ju e dini sa i shtrenjtë është një libër për atë që e shkruan.

Duket që do të jem shfaqur i prekur, por e mblodha veten dhe fola për t’ia nxjerrë kokën bisedës:

- Do ta shoh librin tim të dalë nga shtypi e ta marr në dorë? - desha të shtoj: “E pastaj të bëhet, ç’të bëhet!”, por nuk e thashë, nuk ma tha goja...

Prof. Perlati nuk foli menjëherë. Më pa drejt në sy e me siguri që mendoi: “Ky do të jetë i lajthitur”, pastaj foli ngadalë:

- Do ta shohësh librin tënd! - dhe doli nga dhoma.

Në kartelën time, të pacientit të dhomës nr. 35, në pavijonin e kirurgjisë abdominale, pas vizitës

së parë të plotë, u la shënim ndjekja e terapisë në ditët në vazhdim.

Nga mbrëmja vërshuan telefonatat dhe mesazhet e para, lajmi se isha shtruar në spital i prekur nga Covid-19 kishte dalë si fillim nëpër portale, pastaj në mbrëmje e kishin njoftuar edhe kanalet kryesore televizive. Mendova se ishte detyra ime të bëja një njoftim publik dhe u ula e shkrova me celular njoftimin e mëposhtëm, të cilin e hodha në faqen time të *facebook*-ut:

“I PREKUR NGA COVIDI :-).

Dua të njoftoj miqtë e mi, të afërmit dhe të njohurit e shumtë se pas disa hamendjesh e dyshimesh, për shkak të një gjendjeje dobësie shëndetësore, vendosa të bëj provën e tamponit nëse kjo vinte nga prekja e sëmundjes së shekullit, Covid-19.

Dhe rezultova pozitiv :-).

Pas kësaj, unë dhe familjarët e mi, edhe pse ata nuk rezultuan si unë të prekur, iu nënshtrua vetëkarantinimit, për të mbrojtur jetët tona dhe të të tjerëve, por dhe në zbatim të ligjit, transparencës e në emër të moralit qytetar.

Sot, 5 ditë pas jetës në karantinë i izoluar në shtëpi, vendosa t’u drejtohem institucioneve të specializuara të kujdesit shëndetësor për ta ndjekur gjendjen time shëndetësore, me besimin e plotë në kujdesin dhe aftësitë e tyre profesionale e humane.

U bëj thirrje të gjithë atyre njerëzve që puna, shoqëria apo rastësia i ka bërë të kontaktojnë me mua këtë javën e fundit, të shkojnë e të bëjnë me domosdo provën e

tamponit, për t'u siguruar se janë negativ, për të mbrojtur veten, familjet e tyre, të afërmit dhe gjithë shoqërinë tonë!

Duke besuar në mirëkuptimin dhe vlerësimin e këtij njoftimi jo të këndshëm, ju ftoj të bëni të gjitha përpjekjet për vlerësimin dhe zbatimin e masave me rreptësi dhe rigorozitet për t'u mbrojtur nga kjo flamë, sepse unë që po e provoj ju garantoj se nuk është thjesht një lojë dhe as ekzagjerim i situatës, siç thuhet jo rrallë me mendjelehtësi të çuditshme dhe naive.

Lutem për ju të gjithë, miqtë e mi, që të mos ta provoni këtë situatë, por çdo gjë varet nga secili prej jush!”

Në pak minuta lajmi u bë viral në rrjetet sociale nga mijëra komente, ca mijëra të tjera mesazhe në adresat e mia, telefonata etj., nga vendi dhe shumë vende të botës, siç është e natyrshme të ndodhë në të tilla raste. Por i thashë Irenës që ta marrë përsipër këtë “marrëdhënie me publikun”, në pamundësi që t'u përgjigjesha unë të gjithëve, dhe ajo, pa dyshim, e bëri si askush tjetër duke më lehtësuar shumë. Herë pas here më dërgonte listën e personave që i kishin telefonuar, apo dërguar mesazhe për ta pyetur për shëndetin tim. Përpos familjarëve të mi, vëllezër, motra, farefis e të afërt, nga të parët ishte prof. Rexhep Qosja nga Prishtina. Folëm pak, me sa duket unë do të jem shfaqur i prekur dhe e lamë që të dëgjohej me Irenën për t'u informuar më shumë. Pak më vonë më dërgoi një mesazh të gjatë, prekës